



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM
Per miratim fondi

Nr 44 Datë 06.05.2010

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e politikave të zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me donatorët në Bashkinë Korçë, Per miratim fondi per disa projekte te mbeshtetura nga Keshilli Bashkiak,

Në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 10190 dt. 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", Udhëzimit nr 1 dt. 21.01.2010 te M.F. "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2010, Ligji 9936 date 26.06 2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë"si dhe V.K.B. nr. dt. 25.03.2010 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2010", mbeshtetur ne kompetencat qe ka dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Te miratoje akordimin e fondeve per realizimin e pojekteve "Korca Art", "Suveniret e qytetit", "Kalendaret e aktiviteteve" ne vleren 200 000 leke
2. Ky fond do te perballohet nga fondi i projektit Kinemaja prane femijeve(qe nuk realizohet per arsye te shpalljes se falimentit te Kinemase) me kete strukture buxhetore:

Pakesohet 00 01110 05 art 6040000 – 200 000

Shtohet 00 01110 05 art 6020000 + 200 000

Sipas detajimit te shpenzimeve bashkengjitur relacionitit.

1. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me donatorët dhe Drejtoria e Finances
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Kryetari

Gjergji PENDAVINJI